

VENDIM
Nr. 25, datë 10.1.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën "dh", të pikës 1, të kreut I, pas fjalëve "... të kësaj pike ..." shtohen "... dhe Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës" ...";

b) Në pikën 11, të kreut III, pas togfjalëshit "... të pikës 1, të kreut I ..." shtohen fjalët "... dhe në Zyrën e Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës" ...";

c) Në pikën 5, të lidhjes nr. 3, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Në shkronjën "ç", pas fjalëve "... dhe "koordinator" ..." shtohen "... në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit të Departamentit ...";

ii. Në shkronjën "d", pas fjalëve "... dhe "specialist" ..." shtohen "... në drejtorinë përgjegjëse për dokumentacionin ...";

iii. Në shkronjën "dh", fjalët "... në departamentet përgjegjëse për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave dhe për politikat, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen ..." zëvendësohen me "... në departamentin përgjegjës për politikat, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen ...";

iv. Në nënndarjen "i", të shkronjës "e", fjalët "... aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave ..." zëvendësohen me "... aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave ...";

v. Nënndarja "ii", e shkronjës "e", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ii. "drejtor drejtorie" në departamentin përgjegjës për politikat, integrimin dhe mirëqeverisjen dhe në njësitë përgjegjëse për monitorimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për programimin e akteve rregullatore dhe RIA, në departamentin përgjegjës për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave";

vi. Në shkronjën "ë", fjalët "... në departamentin përgjegjës për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave ..." zëvendësohen me "... në njësitë përgjegjëse për monitorimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për programimin e akteve rregullatore dhe RIA, në departamentin përgjegjës për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave ...".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe fillojnë:

- a) nga momenti i emërimit të nëpunësve/punonjësve për përcaktimet në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi;
 - b) nga momenti i transferimit në pozicionet e reja të nëpunësve në ish-departamentin përgjegjës për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama